



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.1.1--2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË**  
**DOGANËS SË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31**  
**DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Doganës së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Udhëheqësi i Ekipit Blerim Kabashi dhe anëtarëve të ekipit Besa Morina, Pleurat Isufi dhe Fanol Hodolli.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	31
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	32
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	35


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Doganës së Kosovës për vitin 2015 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) të sektorit publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 30/10/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

#### **Opinion i Pamodifikuar**

Pasqyrat vjetore financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


#### **Theksimi i Çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se llogaritë e arkëtueshme të shpalosura janë nënvlerësuar për 606,197€ ndërsa, pasuritë jo financiare janë mbivlerësuar për 308,886€. Kjo është pasojë e mangësive në sistemin e kontabilitetit dhe të raportimit të brendshëm të Doganës së Kosovës

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



## Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm - auditimi 2015

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### **Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes**

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

### **Baza për Opinionin**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Doganës së Kosovës dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

### **Theksimi i çështjes**

Në PVF 2015, DK ka paraqitur totalin e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 44,144,000€. Mirëpo sipas evidencave të siguruara gjatë auditimit, ato janë nënvlerësuar për 606,197€. Mos shpalosja e tyre ka ndodhur për shkak të mangësive në sistemin e kontabilitetit dhe të raportimit të brendshëm të Doganës. Çështja e njëjtë lidhur me mos shpalosjen e plotë të llogarive të arkëtueshme është theksuar edhe në opinionin e auditimit të vitit 2014. Megjithatë, as në vitin 2015 DK nuk ka arritur të siguroj se të gjitha borxhet doganore janë raportuar dhe se ato janë evidentuar me shënimet e nevojshme.

Sistemi për menaxhimin e të hyrave "ASYCUDA World" me vlerë blerëse prej 1,325,865€ ishte prezantuar si investim në vijim edhe pse disa module të tij ishin në përdorim nga viti 2012. Për shkak të kësaj nuk ishte kalkuluar zhvlerësimi për modulet në përdorim. Vlera e akumuluar e zhvlerësimit ishte 308,886€. Si pasoj, në PVF 2015 është raportuar vlera blerëse e sistemit dhe jo vlera neto pas zhvlerësimit prej 1,016,000€.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Menaxhmenti i Doganës së Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshëm të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarim materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Doganës së Kosovës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keq deklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keq deklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarim materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.3 Rreziqet domethënëse në Pasqyra Vjetore Financiare

### Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 30/10/2015, nuk është identifikuar ndonjë rrezik për PVF. Megjithatë, gjatë fazës finale të auditimit ne kemi identifikuar rreziqet me keqdeklarime materiale lidhur me saktësinë dhe plotësinë e llogarive të arkëtueshme dhe pasurisë jo financiare mbi 1,000. Këto keqdeklarime material në PVF 2015 mund të rezultojnë në theksimin e çështjes.

Rreziqet e keqdeklarimeve materiale që ne i kemi identifikuar, ka ndodhur për shkak se sistemi i kontrollit të brendshëm për këto dy fusha nuk ishte plotësisht funksional.

## 1.4 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

### Përshkrimi

Dogana e Kosovës duhet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr.04/L-116 dhe Ligjin nr.04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të buxhetit për 2015;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;



- Raportet për borxhet e papaguara;
- Planin preliminar dhe final të prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 23/11/2015, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti. Në draft Pasqyrat Financiare nuk ishin të nevojshme të bëhen korrigjime financiare. Megjithatë, gjatë auditimit kemi identifikuar mangësi në shpalosje të PVF-ve lidhur me vlerën e pasurisë jo- financiare mbi 1000€ si dhe llogarive të arkëtueshme.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë në përjashtim të shpalosjeve të cekura më lartë.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

---

### **Çështja 1 - Shpalosja jo e plotë dhe jo e saktë e pasurisë jo financiare mbi 1000€ si dhe e llogarive të arkëtueshme në PVF-të 2015-Prioritet i lartë**

**E gjetura** Ne kemi analizuar edhe cilësinë e informacioneve të përfshira në PVF 2015. Në vijim kemi prezantuar çështjet të cilat nuk janë në pajtim me Rregullën Financiare nr.03/2013.

Pasuritë jo financiare mbi 1000€ të shpalosura në PVF 2015 ishin të mbivlerësuara për 308,886€. Po ashtu, llogaritë e arkëtueshme ishin të nënvlerësuara për 606,197€.

**Rreziku** Mos prezantimi i plotë dhe i saktë i shënimeve shpjeguese në PVF-ve shpie në keqkuptim të pozitës financiare duke ofruar informata të pasakta dhe jo të plota në lidhje me vlerën e pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme.

**Rekomandimi 1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që procesi i prodhimit të PVF-ve i adreson dobësitë e identifikuara në PVF plotësisht. - Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.

## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për DK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve. Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar si mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i DK-së. Ky është një tregues që DK ka bërë përpjekje t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe të instaloj një qeverisje efektive.

Dogana ka të hartuar planin strategjik dhe vjetor të punës dhe për të mbështetur këto plane, secili sektor në kuadër të Doganës ka të hartuar planet strategjike sektoriale. Kjo tregon gatishmërinë e Doganës për zhvillimin dhe zgjerimin e aranzhimeve të qeverisjes.

Si kërkesë e menaxhimit financiar dhe kontrollit, DK-ja ka emëruar zyrtarët përgjegjës për menaxhimin dhe implementimin e procesit të menaxhimit të rrezikut. DK ka përzgjedhur ekipin bashkëpunues, të cilët kanë dizajnuar procesin duke hartuar matricën e rreziqeve të mundshme, me të gjitha fazat duke filluar nga: identifikimi, vlerësimi, trajtimi i rreziqeve, monitorimi dhe kontrolli si dhe analizimi dhe raportimi përfundimtar mbi sistemin e menaxhimit vjetor të rreziqeve.

Megjithatë, ky dokument ka nevojë të zhvillohet edhe më tutje me qëllim të përfshirjes së rreziqeve domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Me theks të veçantë, përfshirja e rreziqeve që ndërlidhen me llogarit e arkëtueshme duhet të merret parasysh nga menaxhmenti i Doganës. Kjo duhet të bëhet me qëllim të uljes së rreziqeve që ndërlidhen me llogari të arkëtueshme deri në një nivel të pranueshëm.

Më tej, sistemi i auditimit të brendshëm si hallk kyçe e sistemit të kontrollit të brendshëm ka arritur të mbështesë menaxhmentin lidhur vlerësimin e kontrolleve të brendshme në DK.

## 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit të DK-së për vitin 2014 kishte rezultuar me 14 rekomandime. DK ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të AP-së brenda afatit kohor. Në shtator të vitit 2015, Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) e ka shqyrtuar raportin e auditimit të DK-së për vitin 2014. Gjatë shqyrtimit të raportit ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DK-së të hartoj plane kthyesë të veprimit për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP.

Deri në fund të auditimit për vitin 2015, ne kemi arritur të konfirmojmë implementimin e gjashtë (6) rekomandimeve, gjashtë (6) ishin në proces dhe dy (2) rekomandime nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

---

### Çështja 2 – Mos implementimi i plotë rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- |                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar, megjithatë disa rekomandime ende nuk janë adresuar. Si pasoj, mangësi të njëjta janë përsëritur edhe në vitin 2015. Në veçanti, mangësitë lidhur me proceset e menaxhimit të llogarive të arkëtueshme/borxheve. Kjo është pasojë e mos zbatimit të një procesi formal nga DK për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të AP-së. |
| <b>Rreziku</b>       | Mos implementimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve apo edhe humbje financiare.  |
| <b>Rekomandimi 2</b> | Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit.  |

## 2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për DK-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

---

### Çështja 3 - Lista kontrolluese e vetvlerësimit - Prioritet i lartë

**E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë (6) pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë (5) komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut janë vendosur. Megjithatë rreziqet lidhur me trajtimin e llogarive të arkëtueshme nuk janë përfshi në dokumentin e rreziqeve. Kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1.

**Rreziku** Aranzhimet jo adekuate të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

**Rekomandimi 3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit duke i përfshirë rreziqet potenciale në dokumentin e rreziqeve. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar plotësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit operon MF, dhe sfidat me të cilat përballet.

---

## 2.5.1 Menaxhimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet që të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Dispozitat e LMFP-së si dhe Rregulla Financiare e Thesarit nr. 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçë të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

---

### Çështja 4 - Mos trajtimi i llogarive të arkëtueshme si rrezik në dokumentin për menaxhimin rrezikut- Prioritete i lartë

**E gjetura** DK ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve. Përveç që ka hartuar dokumentin për menaxhimin e rreziqeve ka të hartuar edhe planin e veprimit për monitorimin e gjasës së ndodhjes së atyre rreziqeve dhe ndërmarrjen e masave për t'i sjell në kufirin e pranueshëm. Megjithatë, në dokumentin e rreziqeve DK nuk kishte përfshirë edhe rreziqet që ndërlidhen me llogarit e arkëtueshme në kuptimin e arkëtimit dhe të rritjes së tyre. Duke marrë parasysh, që DK vite me radhë përballet me rritjen e vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme, është e rëndësishme që rreziqet lidhur me këto llogari të përfshihen në këtë dokument.

**Rreziku** Mos përfshirja e llogarive të arkëtueshme si çështje me rrezik në dokumentin për menaxhimin e rreziqeve potenciale, ndikon që menaxhmenti të mos ketë informata të duhura për menaxhimin e tyre dhe uljen e tyre deri në një nivel të pranueshëm.

**Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se do të ndërmerr veprime konkrete për përfshirjen e llogarive të arkëtueshme në dokumentin për menaxhimin e rrezikut, me qëllim të identifikimit, monitorimit dhe uljes së tyre në një nivel të pranueshëm.

## 2.5.2 Sistemi i Auditimit të Brendshëm

### Konkluzioni i Auditimit

Njësia e Auditimi të Brendshëm (NJAB), sipas planit vjetor ka paraparë të kryej shtatë (7) auditime të rregullta, të përqendruara në fushat e rrezikshmërisë së lartë. .

NJAB për vitin 2015 ka kryer gjithësej gjashtë (6) auditime sipas planit vjetor dhe një auditim me kërkesë (Ad hoc). Njëri nga këto raporte ishte kryer sipas planit të vitit 2014 por i finalizuar në fillim të 2015. Tre nga raportet e finalizuara kishin si fushëveprim periudhën janar-dhjetor 2014. Ndërsa, raportet tjera të auditimit kishin periudhën janar-tetor 2015. Për 2015, NJAB nuk kishte arritur të kryejë edhe një raport të planifikuar me planin vjetor.

Përmes raporteve të auditimit, menaxhmentit i janë ofruar informata të rëndësishme për sistemet e disa departamenteve. Drejtoritë/departamentet që auditohen nga NJAB obligohen të raportojnë në perioda tremujore lidhur me nivelin e implementimit të rekomandimeve. NJAB raporton për punën e saj edhe në Departamenti Qendror i Harmonizimit (DQH) përmes raporteve tremujore.

Linja tjetër e raportimit është Komiteti i Auditimit i cili është themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave dhe është në përbërje të pesë anëtarëve. Dogana e Kosovës raporton në këtë komitet me anë të një përfaqësuesi. Komiteti i Auditimit, gjatë vitit 2015 kishte mbajtur 4 takime ku janë shqyrtuar raportet e AB, të gjeturat dhe implimentimi i rekomandimeve të tyre, të gjeturat dhe rekomandimet nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm si dhe plani i veprimit për implementimin e këtyre rekomandimeve.

---

#### **Çështja 5 - Mos përmbushja e plotë e planit vjetor të NJAB-së- Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Sipas planit vjetor për 2015, NJAB kishte planifikuar kryerjen e shtatë (7) auditimeve dhe deri në fund të 2015 kishte arritur të finalizojë gjashtë (6) prej tyre. Auditimi i planifikuar për vitin 2015 dhe i vlerësuar me prioritet të lartë “Kontrolli pas importues” nuk ishte kryer nga NJAB.

**Rreziku** Mos përmbushja e plotë e planit vjetor të AB-së e posaçërisht auditimit të vlerësuar me prioritet të lartë siç është kontrolli pas importues nuk i ofron menaxhmentit siguri se kontrolli ekzistues në këtë fushë të rëndësishme janë funksionale.

**Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj përmes Komitetit të Auditimit se Njësia e Auditimit të Brendshëm e përmbush planin vjetor duke i dhënë prioritet auditimeve të rëndësishme.

#### **Çështja 6 - Lëvizja e stafit nga sektori i burimeve njerëzore në NJAB- Prioritet i mesëm**

**E gjetura** DK me datën 12/03/2014 ka transferuar Zyrtarin Administrativ Ligjor nga sektori i Burimeve Njerëzore në NJAB. Zyrtari vazhdon të jetë anëtarë i NJAB-së me të njëjtën pozitë Zyrtar Administrativ Ligjor për më shumë nuk është përfshirë as në skemën e certifikimit për auditor të brendshëm. Kjo mënyrë e transferimit dhe e rregullimit ekzistues të pozitës së cekur më lart nuk i kontribuon ngritjes së cilësisë së punës së auditimit të brendshëm.

**Rreziku** Stafi me kualifikim jo adekuat në NJAB, e vështirëson punën e kësaj njësie në realizim e objektivave të caktuara me planin vjetor dhe ndikon në cilësinë e auditimeve.

**Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm, në dakordim me Drejtorin e NJAB-së të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave që pozita e caktuar të mbulohet me zyrtar kompetent dhe profesional.

## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

DK për vitin 2015, ka ndërmarr masa proaktive në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Doganës.

Marrë parasysh se aktiviteti kryesor i Doganës është grumbullimi i të hyrave, rezultatet e auditimit kanë treguar që DK në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave. Për vitin 2015, DK ka realizuar 100% të planifikimit vjetor të të hyrave. Krahasuar me 2014, DK ka shënuar rritje për 8% në vitin 2015. Megjithatë, veprime shtesë nevojiten për harmonizimin e të hyrave mes kontabilitetit të Doganës dhe shënimeve të thesarit dhe llogaritjes së shpenzimeve të transportit në DK.

Procesi buxhetor i shpenzimeve në DK gjatë vitit 2015, është përcjell me mangësi. Realizimi i buxhetit final prej 88% tregon nevojën për përmirësime të mëtutjeshme. Me theks të veçantë, buxheti për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale nuk ishte realizuar në nivelin e duhur. Po ashtu, planifikimi i buxhetit duhet të përmirësohet më tutje, për të siguruar klasifikimin, regjistrimin dhe raportimin e shpenzimeve në kategori ekonomike adekuate.

Kontrollet në fushën e shpenzimeve përmes prokurimit janë përmirësuar dukshëm, në përjashtim të disa mangësive specifike. Përderisa, kontrollet në fushën e menaxhimit të personelit dhe menaxhimit të pasurisë kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë për të siguruar zbatimin e kërkesave ligjore.

Më tutje, përkundër masave të ndërmarra në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, ato vazhdojnë të rriten nga viti në vit dhe informatat e prezantuara në PVF 2016 nuk janë të plota dhe të sakta. Përgatitja e programit për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe dërgimi në gjykata i një numri të madh të subjekteve ekonomike për mos pagesën e borxheve ndaj DK-së janë disa nga hapat që DK ka ndërmarr në vitin 2015.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

#### Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MF, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>8,903,000</b>	<b>8,634,000</b>	<b>7,597,000</b>	<b>9,075,456</b>	<b>8,144,009</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,903,000	8,634,000	7,597,000	9,075,456	8,144,009

Buxheti final për 2015 ishte më i vogël se buxheti fillestar për 269,000€. Kjo ishte rezultat i ndryshimeve të mëposhtme buxhetore nga ana e Qeverisë:

- Zvogëlimi i buxhetit për Paga dhe Mëditje në vlerë 155,000€;
- Zvogëlimi i buxhetit për Mallra dhe Shërbime në vlerë 599,000€; dhe
- Rritja e buxhetit për Investime Kapitale në vlerë 485,000€.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit në €**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>8,903,000</b>	<b>8,634,000</b>	<b>7,597,000</b>	<b>9,076,000</b>	<b>8,144,000</b>
Pagat dhe Mëditjet	5,393,000	5,238,000	5,247,000	5,388,000	4,620,000
Mallrat dhe Shërbimet	3,217,000	2,618,000	1,913,000	2,588,000	3,027,000
Shërbimet Komunale	193,000	193,000	92,000	146,000	155,000
Investimet Kapitale	100,000	585,000	345,000	954,000	342,000

Buxheti i vitit 2015 për Mallra dhe Shërbime është realizuar në vlerë prej 1,912,554€ ose shprehur në përqindje 73%.

Buxheti i vitit 2015 për Investime Kapitale është realizuar në vlerë prej 344,960€ ose shprehur në përqindje 59%. Mos realizimi i buxhetit për kapitale në nivelin e duhur ishte rezultat i dështimit të finalizimit të aktiviteteve të prokurimit për projekte të mëdha, ndaljes së proceseve për shkak të ankesave të paraqitura në OSHP si dhe anulimit të aktiviteteve të prokurimit për shkak të mos plotësimit të kriterëve të përcaktuara me dosje të tenderit. Më tutje, fatura në vlerë prej 92,827€ e



pranuar në dhjetor të 2015 nuk ishte paguar në fund vit për shkak të mungesës së faturës origjinale të OE. Kjo faturë është paguar në vitin 2016.

Buxheti për shërbime komunale për 2015 është realizuar 48%. Arsyeja e nivelit të ulët të realizimit të buxhetit në këtë kategori është se në buxhetin e 2015 janë përfshirë edhe shpenzimet e shërbimeve komunale për katër objekte të ndryshme që dogana i ka pasur në shfrytëzim (me qira) deri në fund të 2014. Gjatë vitit 2015, këto shpenzime janë paguar nga Ministria e Administratës Publike (MAP) pasi që këto objekte janë konsideruar qeveritare dhe me Vendim Qeverisë janë mbuluar nga MAP.

**Tabela 3. Të hyrat e inkasuar për buxhetin e Kosovës- realizimi ndaj buxhetit ( në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Pranimet 2015	Pranimet 2014	Pranimet 2013
Të hyrat	962,200,000	946,000,000	951,808,000	870,978,222	844,860,950
Kthimet	(2,300,000)	(3,000,000)	(6,879,000)	(2,407,787)	(3,189,265)
Totali	959,900,000	943,000,000	944,929,000	868,570,435	842,787,317

Të hyrat e planifikuara nga Dogana për vitin 2015 ishin 946,000,000€. Përderisa, realizimi i tyre ishte 944,929,000€, pothuajse plani është realizuar 100%€. Nga trendi i të hyrave nëpër vite vërehet se Dogana ka një ngritje të të hyrave në raport me vitin paraprak për 76,358,565 apo 8.8%€. Po ashtu, Dogana, në vitin 2015 ka një trend të rritjes së realizimit të të hyrave në raport me buxhetin. Në vitin 2014, të hyrat e grumbulluara në raport me buxhetin ishin 93%.

#### **Çështja 7 - Shkalla e ulët e realizimit të bugjetit- Prioritet i lartë**

**E gjetura** Për vitin 2015, DK ka realizuar 88% të buxhetit final- një shkallë më ulët për 4% në raport me vitin 2014. Në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme, mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale ishin sfida kryesore me të cilën ishte përballur DK. Kjo çështje ende nuk është adresuar nga menaxhmenti edhe pse ishte trajtuar në raportet e mëhershme të auditimit. Arsyet për një realizim të ulët të buxhetit përfshijnë vonesat në inicimin e procedurave të prokurimit, anulimet si dhe mos realizimi i kontratave në përputhje me afatin e përcaktuar.

**Rreziku** Realizimi i ulët i buxhetit, do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve si dhe redukton efektivitetin e operacioneve të DK-së.

**Rekomandimi 7** Drejtori i Përgjithshëm duhet ti analizoj më tutje arsyet realizimit të ulët të buxhetit të identifikuar në këtë pjesë të raportit dhe të marr në konsideratë mundësinë për fillimin e hershëm të procedurave të prokurimit për t'i parandaluar sfidat të cilat paraqiten gjatë planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të prokurimit.

#### **Çështja 8 - Keq klasifikimi i shpenzimeve-Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Pagesa për "Furnizim me licenca për antivirus dhe back-up " në vlerë prej 4,017€ është kryer nga buxheti për investime kapitale duke u trajtuar nga DK si pasuri e paprekshme. Megjithatë, licencat për antivirus dhe back-up janë licenca që kanë afat përdorimi njëvjeçar dhe si të tilla duhet të trajtohen si mallra dhe shërbime<sup>1</sup> përkatësisht të paguhen nga kodi ekonomik shërbime kontraktuese tjera (13460).

**Rreziku** Klasifikimi jo i saktë i shpenzimeve rrit rrezikun që pasqyrat financiare të mos japin një pamje të drejtë dhe të vërtet duke mbivlerësuar njërën kategori të shpenzimeve dhe nënvlerësuar kategorinë tjetër.

**Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se planifikimi dhe klasifikimi i projekteve të caktuara bëhet duke pasur për bazë planin kontabël të aprovuar nga Ministria e Financave.

---

<sup>1</sup> Rregullore e MF, Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në OB, neni 3 Pasuri kapitale- nënkupton gjitha pasuritë jo financiare materiale dhe jo materiale që blihen, ndërtohen, krijohen apo përvetësohen në ndonjë mënyrë tjetër dhe që kanë: a) afat përdorimi më të gjatë se një vit dhe që synohet të përdoret vazhdimisht; b) kanë vlerë financiare 1,000€ apo më shumë dhe c) pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB.

---

### 3.4 Të hyrat

#### Përshkrimi

Të hyrat neto të gjeneruara nga DK në vitin 2015 ishin në total 944,929,000€. Dogana në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave. Të hyrat e planifikuara nga Qeveria e Kosovës për vitin 2015 janë 946,000,000€.

Në vijim do t'i paraqesim në mënyrë të detajuar të hyrat dhe kthimet për periudhën vitin 2015.

Nr.	Përshkrimi	Vlera në euro
1	Akciza në kufi	349,876,450
2	TVSH në kufi-dogana	456,518,488
3	Dogana ne import	131,390,851
4	Akciza e Brendshme	10,756,400
6	Kontroll e jashtëm doganore	1,353,172
7	Kundërvajtje e dënime doganore	938,760
8	Banderola	508,057
9	Te hyrat nga shitja e mallrave	313,039
10	Tatimet e tax.tjera nga dogana	153,228
11	Kthimi i akcizës	(4,783,372)
12	Kthimi i taksës doganore	(370,704)
13	Kthimi i TVSH-së	(1,223,579)
14	Kthimi taksa tjera doganore	(500,923)
	<b>Totali I të hyrave 2015</b>	<b>944,929,867</b>

DK në vitin 2015 ka realizuar të hyra për 76,358,565€ apo 8,8% më shumë se në vitin 2014. Rritje më e madhe tregohet tek grumbullimi i akcizës në kufi prej 45,801,205€ apo 15% në raport me 2014. Sipas, DK-së, rritja e të hyrave nga Akciza e jashtme në kufi ishte rezultat i rritjes së sasisë së importit të derivateve, importit të birrës dhe rritja e normës së akcizës për cigare.

Po ashtu, rritje ka shënuar edhe TVSH në kufi prej 32,583,177€ apo 7.6% më shumë se në 2014. TVSH në kufi është taksa e fundit në kalkulimin e taksave të ndryshme doganore, kjo rritje ndërlihet me ngritjen e bazës doganore të taksës doganore dhe të taksës së Akcizës në kufi.

## **Çështja 9 - Mos harmonizimi i të hyrave mes Kontabilitetit të Doganës dhe Thesarit-Prioriteti lartë**

**E gjetura** Sipas rregullores financiare nr. 03/2012, nenit 13- barazimet e të hyrave pas çdo mbyllje të periudhës mujore, DK është e obliguar që të kryej barazimin e të hyrave me librin e përgjithshëm të llogarive në SIMFK.

Sipas Thesarit, në tremujorin e fund vitit 2015 të hyrat neto ishin 944,929,868€, ndërsa sipas kontabilitetit të doganës të hyrat neto ishin 943,853,461€, një mosbarazim në vlerë prej 1,076,407€. Ky mos barazim rrjedh nga pagesat e dyfishta të procesuara në bankat komerciale, të hyrat nga depozitat e lojrave të fatit, transfertat gabim, pagesat e paidentifikuara dhe konfiskimi i garancioneve bankare.

Zyrtari i të hyrave kishte kryer barazimet tremujore të të hyrave me Thesarin, mirëpo në asnjë nga këto raporte të barazimeve nuk ishin dhënë shënime sqaruese sa i përket mosbarazimit ndërmjet kontabilitetit të doganës dhe të dhënave nga Thesari.

**Rreziku** Mos shpalosja e ndryshimeve mes kontabilitetit të Doganës në raport me burimet tjera të të dhënave Thesar përveç që është mjaft shqetësuese njëkohësisht e vë në dyshim edhe besueshmërinë dhe saktësinë e informatave për të dhënat e raportuara të doganës në përgjithësi.

**Rekomandimi 9** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaktarët për mos dhënien e shënimeve sqaruese me rastin e mos harmonizimit të shënimeve të kontabilitetit të DK-së me të hyrat e regjistruara në SIMFK. Kjo duhet të bëhet me qëllim që t'i mundësoj menaxhmentit të DK-së të merr vendime bazuar në informatat e sakta dhe të plota.

### **Çështja 10 - Mos përditësimi i Tarifës së Integruar të Kosovës(TARIK)-Prioritet i lartë**

**E gjetura** Sipas kodit doganor dhe akcizës me rastin marrjes së vendimeve për rritje apo zvogëlim të normave të Akcizës, TVSH-së dhe Taksës Doganore për artikujt e caktuar, sektori për aplikimin e tarifës doganore duhet të përditësojë TARIKUN.

Gjatë 2015, ka pasur rritje të normës së akcizës në produkte si blerja e veturave, cigareve, pijeve alkoolike, dhe vajrave të rënda për ngrohje. Mirëpo sektori për aplikimin e tarifës doganore nuk kishte bërë përditësimin e TARIKUT.

DK ka dërguar disa shkresa zyrtare tek Ministria e Administratës Publike për përditësimin e TARIKUT mirëpo deri në përfundim të auditimit nuk kishin pranuar përgjigje nga MAP.

**Rreziku** Mos përditësimi i tarifës së integruar për rrjedhojë mund të ndikoj në klasifikimin jo të drejt të produkteve dhe kalkulim jo të saktë të taksave. Kjo rrit rrezikun për realizim më të ulët të hyrave doganore për produktet e caktuara.

**Rekomandimi 10** Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me MAP-in duhet të siguroj përditësimin e TARIKUT në afate të rregullta kohore me qëllim të reflektimit të ndryshimeve të normave për taksim. Kjo duhet të bëhet në mënyrë që produktet të klasifikohen dhe të ngarkohen me taksa konform normave të përcaktuara me vendime të Qeverisë dhe mekanizmave përkatëse.

### **Çështja 11 - Mangësi në aplikimin e taksave për shpenzime të transportit dhe në aplikimin e taksave për produkte të njëjta -Prioritet i lartë**

**E gjetura** Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 04/2014 për përcaktimin e koston të shpenzimeve të transportit të mallrave të importuara, neni 4 përlllogaritja e shpenzimeve të transportit detar me kontejner është e përcaktuar me aneksin 2 të këtij udhëzimi.

Tek DUD-i me nr. 20709841 për përcaktimin e vlerës së mallit për çështje të ngarkesës me taksa doganore, shpenzimet e transportit janë kalkuluar 800€ ndërsa është dashtë të kalkulohej 1,200€. Si pasoj kishte nënvlerësim të bazës doganore për çështje të taksave për 400€.

**Rreziku** Kalkulimi jo i saktë i shpenzimeve të transportit me rastin e përcaktimit të vlerës së mallrave për ngarkesë me taksë doganore ndikon në nivelin e inkasimit të të hyrave doganore.

**Rekomandimi 11** Drejtori i Përgjithshëm duhet të përforcoj kontrollet për të siguruar kalkulimin e saktë dhe në pajtueshmëri me kornizën ligjore të shpenzimeve të transportit.

## **Çështja 12 - Kthimi i mjeteve si rezultat i procedurave ankimore dhe pagesave të dyfishta-Prioritet i lartë**

**E gjetura** Numri i aktvendimeve për kthimin e mjeteve nga taksat doganore për 2015 ishte në vlerë prej 1,321,071€, nga degët dhe sektorët e ndryshëm, të cilat realizohen si rezultat i parashtrimit të kërkesës së subjektit ankimor lidhur me taksat e ngarkuara nga Dogana. Ndërsa, 144 lëndë janë kthimet nga bankat komerciale që kapin vlerën prej 1,490,269€, të cilat ndodhin me rastin e pagesave të dyfishta për të njëjtin DUD.

Pas shqyrtimit të kërkesave nga subjektet ankimore lidhur me kthimin e mjeteve në emër të taksave, DK ka marrë aktvendime për kthimin e mjeteve në vlerë prej 1,321,071€. Arsyeja e kthimit të mjeteve ishte se me rastin e përcaktimit të vlerës së importeve apo të shkarkimeve në depo doganore Dogana nuk kishte përdorur metodat e duhura në periudhën kur kanë ndodhur ato.

**Rreziku** Kontrollat jo efektive gjatë vlerësimit të importeve si dhe ekzekutimi i pagesave të dyfishta nga bankat komerciale kanë rezultuar me një numër të konsiderueshëm të ankesave nga subjektet ankimore. Këto kanë për pasojë mos inkasimin e duhur të të hyrave dhe njëkohësisht edhe humbjen e kredibilitetit të institucionit.

**Rekomandimi 12** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollat rreth përcaktimit të vlerës së importeve, në mënyrë që të eliminohet aq sa është mundur mundësia për parashtrimin e ankesave nga subjektet ankimore .

## 3.5 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit. Gjatë auditimit tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim.

---

### Çështja 13 - Nënshkrimi i kontratës me çmime të dyfishuara krahasuar me kontratën e paraprake- Prioritet i lartë

**E gjetura** Pas skadimit të kontratës publike kornizë me kohëzgjatje prej 36 muaj për "Furnizim me banderola për duhan dhe pije alkoolike", DK me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, ka nënshkruar kontratën e re njëvjeçare me të njëjtin Operator Ekonomik (OE), mbi të njëjtat specifikime/termat e referencës si në kontratën publike kornize paraprake.

Dizajni, elementet e sigurisë dhe kualiteti i banderolave sipas kontratës së re janë identike me kontratën bazë, ndërsa çmimet ishin dyfish më të larta, psh. çmimi i banderolave me kontratë të re është 4€/1000 çmimi i furnizimit me ndërsa çmimi sipas kontratës së parë ishte 2€/1000.

**Rreziku** Kontrollat jo efektive gjatë nënshkrimit të kontratës kanë pasur për pasoj furnizimin me banderolla me çmime dyfish më të larta e cila rrit rrezikun për mos arritjen e vlerës për parën e shpenzuar.

**Rekomandimi 13** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratës çmimet e kontraktuara duhet të jenë të njëjta me kontratën paraprake.

### Çështja 14 - Mos përshtatje e normës së re të TVSH me normën e aplikuar në faturë - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, neni 26.1, TVSH ngarkohet me normën standarde prej 18%. Përgjatë kësaj nga paragrafi 1 i këtij neni Norma e reduktuar në TVSH llogaritet dhe paguhet prej 8% për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, përkatësisht paragrafi 2.11 pajisjet e teknologjisë së informacionit.

Në mbështetje të nenit 2 paragrafi 7 dhe 8 i Rregullores për Prokurim Publik, Autoritetet Kontraktuese duhet të rregullojnë kontratat për të aplikuar ndryshimet tatimore të përcaktuara me Ligjin e ri për TVSH. Për këtë qëllim, AK përkatësisht Menaxheri i Kontratës, duhet të harmonizojë çmimin e kontraktuar sipas ndryshimeve tatimore(TVSH-së).

Me rastin e furnizimit me kompjuter Dogana ka paguar 37,942.90€<sup>2</sup> duke aplikuar TVSH me 16% përderisa do të duhej të aplikohet norma TVSH-së prej 8% përkatësisht të paguaj vlerën prej 34,727€, Me këtë rast kishte mbi pagesë prej 3,215€.

Dogana shumë e mbi paguar në vlerë prej 3,215€ e ka korrigjuar duke e zbritur përmes not kreditit /kthime me nr. 16-NOKR1 -1-1 nga fatura me nr. 16-SHV01-1-583 të datës 24/05/2016.

**Rreziku** Mos aplikimi i drejtë i bazës tatimore me rastin e faturimit nga operatori i ekonomik përveç që është në kundërshtim me ligjet në fuqi ka për pasoj edhe dëmtimin financiar të doganës dhe menaxhimi i jo mire i fondeve publike

**Rekomandimi 14** Drejtori i Përgjithshëm në të ardhmen duhet të sigurojë që ndryshimet tatimore të përcaktuara me ligjin e ri të TVSh-së inkorporohen në të gjitha kontratat e prokurimit si dhe pagesat të procedohen sipas normave të reja të TVSh-së.

## 3.6 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### 3.6.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Planifikimi vjetor i buxhetit për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 5,238,414€ ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte në vlerë prej 5,247,274€ që shprehur në përqindje është 100%, madje i tejkaluar për 8,860€. Tejkalmi ka të bëjë me pagesën e përvojës së punës e cila është mbuluar nga Ministria e Financave.

Numri i punëtorëve të planifikuar ishte 622 ndërsa numri i punëtorëve në fund të vitit 2015 në PVF që është 572 punëtorë nuk përputhet me numrin e punëtorëve sipas listë-pagesave në fund të vitit (569) për shkak se zyrtarja e personelit i ka hequr nga lista tre punëtorë, të cilët kanë pezullim(deri në përfundim të mandatit si anëtar të një Bordi)

Testimet tona kanë rezultuar me të gjeturat në vijim:

---

<sup>2</sup> Ekzekutimi i pagesave për furnizim me kompjuterë në vlerë prej 8,360€ dhe 29,582€ Çmimi i kompjuterit sipas specifikacionit teknik ishte 632€ me normë të TVSH prej 16%, në faturë për të njëjtin artikull, çmimi me normë të TVSH-së 8% ishte 643€.

---



## **Çështja 15 - Mangësi sistematike në menaxhimin e burimeve njerëzore - Prioriteti i lartë**

**Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre (UD) për periudhë më të gjatë se kërkesat ligjore.** Sipas Ligjit për Shërbimin Civil në nenin 30" Zëvendësimi i nëpunësit civil në rast të mungesës" në pikën 4 ceket se "Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj".

Sipas vendimit nr. 07.2 të datës 01.09.2014 Udhëheqësi i Njësitit është transferuar përkohësisht në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Udhëheqësit të Sektorit të Logjistikës dhe Arkivit. Kjo pozitë është mbuluar me UD deri me - 02.07.2015 d.m.th është mbuluar me UD për 10 muaj.

Me vendimin te datës 13.05.2016 janë shfuqizuar vendimet paraprake që ka të bëjë me pozitën UD, dhe e njëjta zyrtare është kthyer në pozitën e mëparshme.

**Mos përditësimi i kontratave të punës në pajtueshmëri me detyrat dhe përgjegjësit në punë.** Në kontrata të punës me kohë të pacaktuar nuk është e përcaktuar grada dhe paga bruto e punëtorit që korrespondon me gradën, as përshkrimi i vendit të punës me detyrat dhe përgjegjësit që përkojnë me atë vend të punës.

Në katër raste ( dy staf civil dhe dy staf doganor) nuk përmbanin përshkrimin e detyrave dhe të përgjegjësave. Në tri raste tjera të emërimeve në detyrë, qoftë transferim apo emërim i përkohshëm nuk kishte përshkrim të detyrave të reja të të punësuarve si dhe për të njëjtit në dosje mungonin vlerësimet e performancës së punëtorëve edhe pse ishin avancuar përkohësisht në pozitë.

**Aprovimi i pushimit pas shfrytëzimit.** Me datën 26.06.2015, zyrtari i DK-së kishte paraqitur kërkesën për lejimin e pushimit pa pagesë në të cilën kërkohej pushimi prej datës 19.06.2015.

Sipas evidencës mujore të prezencës në punë, pushimi pa pagesë është nga data 19.06.2015. Ndërsa, vendimi për miratimin e kërkesës për pushim pa pagesë mban datën 10.07.2015.

**Pagesa e shtesave për rrezikshmëri pa bazë të qartë ligjore.** Shtesat mujore për rrezikshmëri për stafin e doganës, nuk janë të njëjta për të gjithë përfituesit. Përcaktimi se cila pozitë është përfituese e shtesës-rrezikshmëri në vlerë prej 107€ dhe cila me vlerë prej 150€, nuk është e rregulluar me ndonjë akt ligjor apo rregullore të brendshme.

**Rreziku** Mbulimi i pozitave me UD, pagesa e shtesave pa një bazë të qartë ligjore si dhe mos përditësimi i kontratave të punës në pajtueshmëri me detyrat dhe përgjegjësit në punë mund të rrisin rrezikun në dështimin e përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi në sektorët përkatëse si dhe rrezikon performancën e përgjithshme të DK-së.

**Rekomandimi 15** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave të caktuara me punëtorë të rregullt. Më tutje, duhet të siguroj bazën e qartë ligjore lidhur me pagesën e rrezikshmërisë për personelin përbrenda institucionit si dhe marrjen e vendimeve me kohë për të evituar pushimet pa pagesë pa aprovime paraprake. Po ashtu, duhet të siguroj përditësimin e dosjeve të personelit në pajtueshmëri me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i ushtrojnë.

## 3.7 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### Përshkrimi

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Dogana e Kosovës ka nxjerrë edhe dy rregullore të brendshme për menaxhimin e pasurisë.

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (me vlerë mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 5,141,385.50€, vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 336,920.00 € si dhe stoqet në vlerë prej 260,750.00 €.

Në vitin 2014 vlera e pasurisë jo-financiare kapitale ishte 4,803,470€. Pra, në vitin 2015 kemi rritje të pasurive për 7% sepse DK gjatë vitit 2015 ka pasur blerje dhe donacione. Por arsye tjetër e kësaj rritjeje ishte se në mungesë të zyrtarit të pasurisë gjatë 2014, pasuritë të cilat nuk ishin regjistruar gjatë vitit 2014 janë regjistruar në vitin 2015 duke iu llogaritur edhe zhvlerësimi.

## Çështja 16 - Mbivlerësimi i pasurive jo financiarë mbi 1000 € në regjistrin kontabël - Prioritet i larte

**E gjetura** Pasuritë kapitale me vlerë fillestare 1,325,865€ në regjistrin kontabël janë regjistruar si *Investime në vijim (Kodi ekonomik 32500)*. Kjo vlerë i përket projektit për implementimin e sistemit ASYCUDA World, i cili në faza të ndryshme, sipas moduleve, është funksionalizuar. Kontrata bazë për implementimin e sistemit ASYCUDA World e ratifikuar me 06.05.2011 në vlerë prej \$1,3 mil. dhe anex kontrata e nënshkruar me 04.11.2014 mbi kontratën bazë, në vlerë prej 501,330\$ kishte paraparë të zhvillohen-ndryshohen 11 module.

Disa module të sistemit janë funksionalizuar prej vitit 2012, mirëpo të njëjtat nuk janë klasifikuar si pasuri në përdorim dhe nuk është llogaritur zhvlerësimi në vite dhe vlera neto. Ky sistem në regjistrin kontabël figuron si investim në vijim. Zhvlerësimi i akumuluar me 31.12.2015 për vlerën fillestare të lart cekur do të ishte 308,886€ dhe vlera neto 1,016,978€.

Pagesa në vlerë prej 8,254€<sup>3</sup> për rregullimin e pllatos në pikën kufitare të Kosovës në Vërmicë është bërë nga kategoria e investimeve kapitale nën kodin ekonomik (31120)- Ndërtesa administrative afariste. E njëjta nuk është regjistruar në regjistrin kontabël si pasuri.

DK nuk kishte mbajtur evidenca për gjendjen e pasurive financiare nën 1000€ dhe stokut në sistemin kontabël e-pasuria.

**Rreziku** Regjistrimi i pasurisë si investime në vijim të pasurisë e cila është në përdorim si dhe mos regjistrimi fare i pasurisë në regjistra kontabël ndikon që vlera e pasurisë së prezantuar në PVF të mos jetë e saktë dhe e plotë.

**Rekomandimi 16** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerr veprimet e duhura që pasuritë të klasifikohen saktë në regjistrin kontabel dhe në programin e-pasuria, në mënyrë që vlera financiare e raportuar në raporte të jetë e plotë dhe e saktë.

---

<sup>3</sup> Pagesa në vlerë prej 8,254€ është bërë sipas urdhër pagesës së datës 26.06.2015.

### 3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

#### Përshkrim

Sipas Sektorit për Mbikëqyrje të Transitit, Garancit dhe kontabilitetit Doganore/Borxhit (SMTGKB) borxhet ndaj doganës ishin në vlerë prej 44,750,197€. Përderisa, borxhi në fund të vitit 2014 ishte 34,617,788€. Në vitin 2015, rritja e borxhit në vlerë prej 10,132,409€ vjen si rrjedhojë se SMTGKDB ka arritur që t'i regjistroj në sisteme borxhet nga vitet e më hershme të cilat nuk kanë qenë të regjistruara dhe të raportuara nga sektori përkatës.

Borxhet ndaj DK-së kanë të bëjnë me Akcizën për lojëra të fatit dhe për prodhimin e pijeve alkoolike dhe jo alkoolike në vlerë prej 24,764,292€, kontrollet pas importuese në vlerë prej 9,360,190€, kundërvajtjet për subjekte ekonomike dhe persona fizike në vlerë prej 6,034,567€ si dhe të tjera 4,591,148€.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borgjeve publike, dogana ka përgatitje dhe ka dërguar listat për faljen e borgjeve në Ministrinë e Financave.

Sipas listës për falje të borgjit për subjekte juridike –deri në vitin 2008 borxhet arrin vlerën prej 5,641,168 €, ndërsa borxhet prej vitit 2008 deri në vitin 2015 arrin vlerën prej 541,869€ - pagesë me kusht që të përfitojnë faljen.

Ndërsa sipas listës për falje të borgjit për personat fizik - deri në vitin 2008 borgjet arrin vlerën prej 429,232€, ndërsa borxhet prej vitit 2008 deri 2015 arrin vlerën prej 43,030€ - pagesë me kusht që të përfitojnë faljen.

Deri në përfundimin e procesit të auditimit, subjektet dhe personat fizikë që janë përfshi listën e përfitueseve për falje të borxheve ende nuk kishin marrëveshje me Doganën për të përfituar nga kjo falje. Më tutje, dogana këtë vlerë e kishte prezantuar në PVF 2015 dhe në raportet e saja financiare për borxhet ndaj doganës në fund të vitit 2015.

Sektorët përgjegjës<sup>4</sup>, kanë proceduar rastet në gjykata dhe te përmbaruesit ndaj një numri të konsiderueshëm të subjekteve juridike dhe personave fizik të cilët vazhdojnë të kenë detyrime të pa shlyera ndaj Doganës.

---

<sup>4</sup> Sektori për Mbikëqyrjen e Transitit, Garancitë dhe Borxheve si dhe Sektori i Përfaqësimeve i themeluar në vitin 2015 për dorëzimin e lëndëve në Gjykata

## Çështja 17 - Mos funksionalizimi i sistemit apo platformës NUXEO-Prioritet i lartë

### E gjetura

Dogana ende nuk e ka funksionalizuar sistemin elektronik për evidentimin dhe menaxhimin e borxhit doganor. Sektori për menaxhimin e borgjeve nuk kanë arritur të siguroj se të gjitha borxhet doganore janë raportuar dhe evidentuar me të gjitha shënimet e nevojshme për veprimet e ndërmarra në lidhje me ato borxhe.

Sektori për Mbikëqyrjen e Tranzitit, Garancitë dhe Kontabilitet Doganor/Borxhi, borxhet e raportuara i regjistron në një faqe të thjeshtë Excel. Mirëpo kjo formë e regjistrimit nuk garanton sigurinë e të dhënave dhe funksionalitetin e menaxhimit me borxhin doganor. Më tutje, DK nuk ka arritur të siguroj dëshmi për të mbështetur vlerën e borxheve të prezantuar në PVF. Gjatë auditimit, DK ka ofruar shënime të ndryshme sa i përket vlerës së borgjeve të vitit 2015.

Sipas zyrtarëve të Doganës, aktivizimi i sistemit është i nevojshëm pasi që ka kapacitet të sinjalizoj se një borxh nuk është papaguar në momentin e borxhit i kalon afatit për pagesë. Në këtë mënyrë DK do të identifikoj me kohë mos pagesën e borxhit dhe do të vendos për hapat e mëtutjeshëm. mund të

**Mos ekzekutimi i ndalesave për kryerjen e procedurave import/eksporte për subjektet të cilat figurojnë në listën e borxhlinjve ( lista pezulluese).** Sipas Aktvendimit të Drejtorit të DK-së, subjektet ekonomike që gjenden në Listat për pezullimin e procesit të zhdoganimit të mallrave në import/eksport, pezullimi do të vlejë deri në shlyerjen e plotë të borxhit ekzistues që figuron në listë. Ne kemi identifikuar se katër subjekte ekonomike, pavarësisht që kanë qenë në listën pezulluese ato kanë vazhduar procesin e zhdoganimit të mallrave.

Subjekti ekonomik me nr. fiskal 600109971 pezullimi për subjektet që gjenden në këtë listë fillon nga data 02.11.2015. Ky subjekt ka pasur marrëveshje me DK për shlyerjen e borxhit prej 11,503€ në 12 këste. Marrëveshja është e datës 02.12.2014. Ne kemi identifikuar që ky subjekt nuk i është përmbajtur marrëveshjes. Sipas aktvendimit të datës 30.10.2015 pezullimi për këtë subjekt vlen deri në shlyerjen e borxhit total ndaj doganës. Përkundër kësaj subjekti ka kryer procedurë të importit me datë 06.11.2015.

Subjekti ekonomik me nr. fiskal 600304761, me borxh në vlerë 19,869€ paraprakisht me datën 05.12.2014 ka lidhur marrëveshje me doganën për pagesën e borxhit prej 16,497€ në 12 këste. Subjekti nuk e kishte respektuar marrëveshjen. Në aktvendimin e datës 23.10.2015 cekët që këtij subjekti i pezullohet e drejta e zhvillimit të procedurave import/eksport deri në shlyerjen e plotë të borxhit doganor. Pavarësisht kësaj, subjekti ka kryer procedura të importit të mallit nga data 05.11.2015.

**Rreziku**

Mos funksionalizimi i sofwerit NUXEO nuk i ofron siguri menaxhmentit të doganës se të gjitha borxhet doganore janë raportuar dhe evidentuar me gjithë shënimet e nevojshme.

**Rekomandimi 17** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka ndërmarr masa të duhura për funksionalizimin e sistemit me qëllim të evidentimit të të gjitha borxheve në sistemin NUXEO. Më tutje, duhet të vazhdoj të ndërmarr veprimet ligjore si dhe të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarim materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarim materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarim materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarim materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarim materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarim të, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarim të, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarim materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
2.2 Rreziqet domethënës ne PVF	Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndërmerr veprime konkrete për të siguruar se regjistrat lidhur me llogarit e arketueshme janë të sakta dhe të plota.		Të adresuara por jo plotësisht të implementuara	
3. Rekomandimet e vitit paraprake 2014	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se masat e përcaktuara në planin e veprimit për depot doganore dhe llogarit e arkëtueshme të rishikohen dhe monitorohen në vazhdimësi për të siguruar që ato zbatohen plotësisht nga stafi llogaridhënës gjatë kryerjes së aktiviteteve të përditshme.		Të adresuara por jo plotësisht të implementuara	
4.1 Planifikimi dhe realizimi i bugjetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për shërbime komunale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për mallra dhe shërbime ka analizuar mangësitë në procesin e prokurimit për evitimin e tyre në të ardhmen.			Të pa adresuar
4.2 Të Hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka shtuar nivelin e monitorimit në lidhje me vlerësimin e importeve doganore, si dhe të eliminoj dobësitë të cilat mund të paraqiten gjatë caktimit të vlerës doganore për mallrat e importuara	Implementuar		

4.2 Të Hyrat, gjendja e stokut ne depo doganore	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka forcuar mbikëqyrjen e depove doganore duke shtuar kontrollet në këto subjekte, për të verifikuar nëse janë duke u zbatuar kushtet e autorizimeve dhe për të verifikuar gjendjen e stoku	Implementuar		
4.2 Të Hyrat, kthimi i mjeteve	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrole adekuate duke ngritur nivelin e performancës në përcaktimin e vlerave të importeve, në mënyrë që të reduktohet aq sa është e mundur numri i ankesave nga subjektet ankimore.		E adresuar por jo plotësisht të implementuara	
4.3.1 Prokurimi, dhenje kontratës pa sigurim te ekzekutimit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj ngritjen e nivelit të kontrollit në mbarvajtjen e procesit të prokurimit sipas kërkesave ligjore. Më tutje, duhet të siguroj që me rastin e nënshkrimit të kontratës, paraprakisht është depozituar siguria e ekzekutimit e barabartë apo jo më pak se 10% e vlerës së kontratës	Implementuar		
4.3.1 Prokurimi pranimi i shërbimeve kualiteti i dobet	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj monitorim të mjaftueshëm në pranimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe të merren veprimet e duhura për të siguruar që shpenzimi i parasë publike bëhet në mënyrë efikase dhe duke eliminuar rreziqet/devijimet nga rregullat ligjore.	Implementuar		
4.3.1 Prokurimi klasifikimi jo adekuat i kodit ekonomik	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj vendosjen e një sistemi funksional të kontrollit rreth procedimit të pagesave për mallra dhe shërbime për të siguruar që pagesat janë regjistruar dhe raportuar në kode ekonomike adekuate për të evituar mangësit në këtë fushë.		Të adresuara por jo plotësisht të implementuara	

4.3.2 Kompensim paga dhe mëditje, ndalesat per shfytzimin e pushimit mjeksore per stafin civil	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka respektuar të drejtën e shfrytëzimit të pushimit mjekësor për stafin civil pa aplikuar ndalesat në pagë	Implementuar		
4.3.2 Kompensimi paga dhe mëditje pagesa per reprezentacion jo nga kategoria e duhur	Drejtori i Përgjithshëm, duhet të siguroj që shpenzimet e reprezenacionit janë paguar nga kategoria adekuate.	Implementuar		
4.3.2 Kompensimi paga dhe mëditje mungon pershkrimi i qarte i detyrave dhe përgjegjësi	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësi të bëhen sa më shpejtë që është e mundur. Me rastin e transferimit të punonjësve apo emërimeve në detyrë, duhet të bëhet azhurnimi i dosjeve me pozita të aprovuara.			Të pa adresuar
4.4.1 Pasurit dhe detyrimet, mangësi ne menaxhimin e pasurive te Doganes	Drejtori i Përgjithshëm duhet të analizojë arsyet për mangësit e paraqitura në menaxhimin e pasurisë për vitin 2014. Po ashtu të siguroj prezantimin e saktë dhe të plotë të pasurive në PVF 2015.		Të adresuara por jo plotësisht të implementuara	
4.4.2 Trajtimi i llogarive te arketueshme	Drejtori i Përgjithshëm duhet të identifikoj çdo borxhëlinj ndaj Doganës, dhe të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshme – (duhet të klasifikohen, dokumentohen dhe validohen). Të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë veprimet ligjore. Rishikimi duhet të përfshihë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve ndaj Doganës		Të adresuara por jo plotësisht të implementuara	